



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 45
Prishtinë, më 19.7.2019
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Albert Kinolli, Emilija Rexhepi, Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Valon Ramadani dhe Etem Arifi.

Munguan: Verica Qeraniq, Faton Topalli, Ali Lajçi dhe Avdullah Hoti.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Antigona Ibraj, Ajet Avdullahu, Flakë Hajdini dhe Sara Idrizi.

Të ftuar: Përfaqësuesit e Kompanisë Regjionale “KRU Prishtina” Ilir Avdullahu, Besim Berisha, Amir Gashi dhe Sokol Duraku, përfaqësuesit e Ndërmarrjes Publike “Posta e Kosovës” të cilët nuk iu përgjigjen ftesës së komisionit.

Pjesëmarrësit tjerë: Ganimete Dalloshi Hoxha, Fitim Haliti dhe Arvita Zyferi nga ZKA-ja.

Rendi i Ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 4 dhe 9.7.2019;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Kompanisë Regjionale “KRU Prishtina” për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Ndërmarrjes Publike “Posta e Kosovës” për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018;**
- 5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;**
- 6. Të ndryshme.**

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 4 dhe 9.7.2019;

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtura më 4.7.2019 dhe 9.7.2019, u miratuan pa vërejtje nga ana e deputetëve.

3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Kompanisë Regjionale “KRU Prishtina” për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018;

Valon Ramadani – Opinioni i Auditimit i Kompanisë Regjionale KRU “Prishtina” për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 është i kundërt. Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” sh.a nuk paraqesin një pamje të drejtë në të gjitha aspektet materiale. Menaxhimi i të hyrave ka nevojë për përmirësim, kjo pasi që kontrollet në këtë fushë ishin të dobëta dhe kanë pamundësuar njohje të saktë të tyre në pasqyrat financiare si dhe të evidentohen vonesat në legalizim të konsumatorëve, regjistrim pa i mbushur kërkesat e përcaktuara, mosaplikim të masave ndëshkuese ndaj borxhlinjve dhe raste të evidentimit të konsumatorëve pa përshkrim të emrit dhe numrit personal. Z. Ramadani do të donte të dinte nëse kompania i ka korrigjuar çështjet e lartpërmendura, përfshirë edhe vonesa në ujëmatës të konsumatorëve individualë, ku nga dymbëdhjetë mostrat është vërejtur se procedurat e legalizimit ishin vonuar nga një muaj deri në një vit, ndërsa në dy raste edhe pse kërkesat ishin bërë nga muaji prill, respektivisht shtator të vitit 2018, ende nuk ishte bërë verifikimi i tyre nga komisioni për verifikim të gjendjes në terren. Gjetja tjetër ka të bëjë me faturimin e konsumatorëve, jo në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ARRU-ja dhe nëse janë ndërmarrë hapa për korrigjim në lidhje me këtë të gjetur dhe a janë njohur pagesat apo borxhet e konsumatorëve.

Sa i përket prokurimit të mallrave, pyetja qëndron në faktin se kush është operatori dhe pse janë shkelur rregullat e prokurimit, në rastin e furnizimit me vetura të përdorura dhe me të dhënat e ARRU-së, ku tregohet se humbja e ujit për 2018 ishte rreth 58% ndërsa në 2017 rreth 57%. Në fund deputeti raportues dëshiron të dijë nëse të gjeturat janë adresuar nga KRU “Prishtina” dhe a është përgatitur plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Kryetari, potencoi faktin se opinioni i auditimit është më negativ gjë që përbën problem për të krijuar një bazë diskutimi dhe se kjo çështje duhet adresuar në seancë plenare apo të merret prokuroria me këtë.

Betim Berisha, kryesues i Bordit të KRU “Prishtina”, tha se pas pranimit të raportit nga ZKA-ja Bordi i KRU “Prishtina” ka mbajtur mbledhje me menaxhmentin e kompanisë, ku është

kërkuar hartimi i planit të veprimit për eliminimin e të gjeturave. Me hartimin e këtij plani konkret besohet që vitin e ardhshëm opinioni i raportit të ZKA-së të jetë më pozitiv.

Iliir Avdullahu – KRU “Prishtina” brenda vetëm dy ditëve ka kryer pagesa për taksa në shumë 10,000€. Temë diskutimi në vitin paraprak ka qenë furnizimi me ujë për Fushë- Kosovën ku deri në këtë vit është arritur furnizimi me ujë të pijshëm për një perimetër i cili përfshinë rreth 50,000 banorë. Sa i përket të gjeturës që kompania nuk ka bërë rivlerësimin e aseteve, kompania e ka marrë me seriozitet trajtimin e kësaj çështjeje dhe procedurat e rivlerësimit janë pothuajse në përfundim. Shumë probleme të kompanisë janë të natyrës teknike si rrjedhojë e faktit se kompania ka rreth 140,000 konsumatorë me një staf me moshë mesatare 45.5 vjeçare.

Kryetari, pyeti se në tabelat financiare paraqiten shpenzimet për sport dhe kulturë me vlerë prej 7,42€ çfarë shpenzime konkrete ka bërë kjo kompani në këtë sferë?

Zyrtari Kryesor Financiar – Shpenzimet për sport dhe kulturë janë bërë në kuadër të disa aktiviteteve për fushata vetëdijesuese kulturore që ndërlidhen me kursimin e ujit.

Kryetari, theksoi faktin se në krahasim me vitin 2017 në vitin 2018 ka një rritje në shpenzimet për mëditje dhe udhëtime zyrtare gati 86% dhe se miratimi i këtyre mëditjeve është bërë në mospërputhje me rregulloren e brendshme.

Zyrtari Kryesor Financiar – Te udhëtimet zyrtare është evidente, pasi që kompania është e angazhuar në shume trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është pjesëmarrëse në konferenca të ndryshme, ku njëra ndër to është edhe Konferenca e Danubit, ku kompania është anëtare me të drejta të plota. Sa i përket mëditjeve, kompania posedon një rregullore, të cilën bordi i ri është duke e rishikuar, në mënyrë që në të ardhmen të mos bëhen shkelje.

Valon Ramadani, pyeti për hapat konkret të cilët janë ndërmarrë për gjetjet e bëra nga ZKA-ja. Ai theksoi se në vitin 2017 gjendja nuk ka qenë e mirë dhe se ka pasur keqpërdorime. Raporti i auditimit jep raport të kundërt për institucionin dhe se përgjegjësia duhet të kërkohet tek personat kompetentë për të gjitha keqpërdorimet dhe vjedhjet e bëra gjatë ushtrimit të detyrës. Ai propozoi që ky raport të dërgohet për seancë plenare, dhe se prokurori të merret me shqyrtimin e këtyre keqpërdorimeve. Z. Ramadani thekson se duhet të ndëshkohen përgjegjësit sepse në të kundërtën kjo do të jetë motivim për keqpërdorime në vitet e ardhshme, pasi që në fund të vitit do të diskutohet raporti dhe në fund nuk ndëshkohet askush!

Andin Hoti, përmendi se nga raporti i ZKA-së kanë dalë gjithsej 20 rekomandime për raportin e vitit 2017, ku 10 prej tyre janë zbatuar gjatë vitit, dhe 7 nuk janë adresuar ende. Pyetja e Z. Hotit ishte se a janë të përfshira në raport si të gjetura edhe këto 7 rekomandime që nuk janë adresuar nga viti 2017.

Zyrtari Kryesor Financiar, theksoi se disa prej rekomandimeve janë adresuar dhe disa janë në proces, siç janë vlerësimi i aseteve dhe pjesa e cila nuk është adresuar do të jetë tek pjesa e raportit. Ai përmendi se kanë nisur hapat e parë për adresimin e rekomandimeve dhe se dy menaxherë të dy departamenteve janë shkarkuar. Ndërsa, plani i veprimit i adresimit të rekomandimeve është në përfundim dhe do të përcillet tek KMFP-ja në ditët në vazhdim.

Kryetari, propozoi që diskutimi të mbyllet dhe bashkërisht të vendoset se si të procedohet me këtë raport. Ai theksoi se është shumë shqetësuese mënyra se si po menaxhohen ndërmarrjet publike dhe se performanca duhet të përmirësohet gjithsesi.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e KRU “Prishtina” për vitin e përfunduar 2018, të adresohet për në seancë plenare, së bashku me rekomandimet e Komisionit funksional.

4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Ndërmarrjes Publike “Posta e Kosovës” për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018;

Për shkak të mungesës së përfaqësuesve të Ndërmarrjes Publike “Posta e Kosovës”, në këtë mbledhje të komisionit, u vendos që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së komisionit.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;

Kryetari, njoftoi deputetët dhe të pranishmit se për të arritur deri tek ky raport KMFP-ja ka pasur vizita në disa institucione, janë organizuar disa punëtori, si me kryetarët e komunave të rajonit të Prizrenit, me NJQHAB të MF, takimi me Ministrinë e Financave takimi me Ministrinë Infrastrukturës dhe më pastaj në bashkëpunim me D+ është përpiluar një raport me të gjeturat, i cili duhet të miratohet në komision, në mënyrë që të dërgohet në seancën plenare për miratim. Me këtë hapi diskutimin.

Përfundim

Pas hedhjes në votim të raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Komisioni vendosi të njëjtin ta adresojë për në seancë plenare.

6. Të ndryshme.

Në mbledhjen e radhës së komisionit të paraparë për tu mbajtur më 23.7.2019, u vendos të ftohet Ndërmarrja Publike “Posta e Kosovës” (raportues z. Driton Selmanaj), Ndërmarrja Publike Telekomit i Kosovës (raportues z. Albert Kinolli) dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë (raportues z. Andin Hoti).

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Driton Selmanaj